



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 221

Tiranë – E hënë, 18 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 139, datë 1.12.2017	Për delegim kompetence..... 11829
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 77, datë 23.11.2017	Autorizim i dhënies së ndihmës shtetërore, “Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme” 11829
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 189, datë 23.11.2017	Mbi miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal..... 11835
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 190, datë 23.11.2017	Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike..... 11841
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arent Gega..... 11843

**URDHËR****Nr. 139, datë 1.12.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në zbatim të nenit 14, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nenit 28, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, nga data 4 dhjetor deri më datë 6 dhjetor 2017, zëvendëskryetarit të AMA-s, z. Sami Nezaj.

2. Ngarkohet zëvendëskryetari, z. Sami Nezaj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gentian Sala

VENDIM**Nr. 77, datë 23.11.2017**

AUTORIZIM I DHËNIES SË NDIHMËS
SHTETËRORE, “MASAT
MBËSHTETËSE PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
BURIMET E VOGLA TË
RINOVUESHME”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

z. Arben Ahmetaj	kryetar;
znj. Mimoza Dhëmbi	anëtar;
z. Ahmet Mançellari	anëtar;
z. Petrit Bakiu	anëtar;
z. Gramoz Hoxha	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 23.11.2017, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim planin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në projektvendimin “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes

së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”, e hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

I. Procedura

1. Me shkresën nr. 815/1, datë 1.11.2017, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) njoftoi në Komisionin e Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë masën e sipërpërmendur, duke respektuar detyrimin për njoftimin e ndihmës në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Projektvendimi “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” ka si qëllim përcaktimin dhe miratimin e një metodologjie që do të bëjë të mundur llogaritjen dhe vendosjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, që do t’i paguhet prodhuesve të ardhshëm të energjisë elektrike nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

3. Objektivi kryesor i masës së njoftuar është rritja e kapacitetit të energjisë së rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, duke ndihmuar vendin tonë të arrijë përmbushjen e detyrimit të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Sipas njoftimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ekziston një interes në rritje për aplikimin e metodave te pastra të gjenerimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, nëpërmjet impianteve të shfrytëzimit të mbetjeve të ngurta urbane/MNU në nivelin e gjenerimit të mbetjeve vjetore nga 80 në 120 mijë tonë/vit (40 në 65 mijë tonë MNU të djegshme), dhe deri në vitin 2025 të arrihet rikuperim i energjisë nga 15% i mbetjeve bashkiake.



III. Fushëveprimi i njoftimit, baza ligjore, autoriteti i dhënies

4. Njoftimi ka të bëjë me ndihmën operacionale për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW, i cili caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon çështjet e energjisë. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016.

5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton se ndihma jepet vetëm për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, siç përcaktohet në ligjin nr. 7/2017, neni 10, “Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme”.

6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është autoriteti dhënës për masën e njoftuar. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a) është zbatues i skemës, sepse në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 69¹, merr përsipër të kryejë veprimtaritë e nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar.

IV. Përfituesit:

7. Përfituesit e ndihmës janë ndërmarrjet që operojnë me burime të rinovueshme të energjisë (në vijim “RES-E”), që prodhojnë energji elektrike nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Në njoftim nuk jepet kohëzgjatja e skemës, por nuk mund të kalojë 15 vjet.

V. Forma e ndihmës

8. Masa mbështetëse bazohet në vendosjen e një tarife FIP (*Feed-in-Premium*) bazuar në metodologjinë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Sipas njoftimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë rezultoi se shoqëria OSHEE sh.a., së cilës i është ngarkuar detyrimi i blerjes së energjisë nga prodhuesit e energjisë elektrike nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, do të parashikojë në të ardhurat vjetore të kërkuara likuiditetet e mjaftueshme për ekzekutimin e pagesave, *brenda tavanit maksimal të çmimit të shitjes së energjisë për furnizimin e klientëve tariforë*. Në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore, tarifatat duhet të mbulojnë diferencën e çmimit të tregut të energjisë dhe kostos së mesatarizuar të energjisë elektrike të prodhuar (*levelised costs of producing energy* (LCOE)).

9. Plani Kombëtar i Veprimit të Burimeve të Energjisë së Rinovueshme (PKVBER) 2015-2020² parashikon kapacitetin e nevojshëm për të arritur objektivin kombëtar për vitin 2020, duke parashikuar instalimin e njësisve të prodhimit të energjisë nga biomasa ose ndryshe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta urbane. Ligji i ri nr. 7/2017 parashikon vendosjen e tarifave FIP (*Feed-in-Premium*) me anë të një procesi konkurrues, jo diskriminues të tenderimit (ankande) nëpërmjet Kontratave për Diferencë (CfD), ndërsa instalimet e reja deri në 2 MW përjashtohen nga procesi konkurrues me çmimin tavan, që do të vendoset bazuar në metodologjinë që propozohet në këtë njoftim të skemës së ndihmës. Në pikën 4.4.5, “Funksionimi i rrjetit të energjisë elektrike”, parashikohet se të gjitha impiantet e energjisë me burime të rinovueshme të energjisë (BRE) janë të integruar në tregun e energjisë elektrike. Tregu i energjisë elektrike

²VKM nr. 27, datë 20.1.2016, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për burimet e energjisë së rinovueshme, 2015 – 2020”, pika 4, “Masat për arritjen e objektivave specifike në secilin sektor”, nënpika 4.1, “Përmbledhje e politikave dhe masave për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme”, 4.1.2 Skemat mbështetëse promovuese të BRE-E në tregun e energjisë.



është projektuar sipas modelit shqiptar të tregut të miratuar nga VKM-ja nr. 338, datë 19.3.2008. Ky model tregu kërkon që e gjithë energjia elektrike e prodhuesit të shpërndarë (HECV) të blihet nga blerësi me një tarifë të rregulluar promovuese të miratuar nga ERE.

10. Skema financohet nga një “taksë”, e ashtuquajtura detyrim i shërbimit publik (ndaj OSHEE sh.a.), të cilit i është ngarkuar detyrimi për blerjen e energjisë së prodhuar nga prodhuesit e energjisë nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta dhe më pas për ta ofruar dhe shitur në treg të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike në përputhje me modelin e tregut. Skema është e dizenuar për të mbështetur disa objektiva të politikave kombëtare, të tilla si përdorimi i burimeve të rinovueshme në prodhimin e energjisë elektrike. Ndihma do t'i jepet atyre furnizuesve me pakicë të energjisë elektrike që nënshkruajnë Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë (*Power Purchase Agreement-PPA*) me gjeneruesit e energjisë së rinovueshme (RES-E). Megjithatë, përfituesit indirektë (finalë) të ndihmës janë gjeneruesit RES-E.

11. Sipas një PPA-je, furnizuesi (OSHEE sh.a.) merr përsipër të blejë të gjithë prodhimin nga një përzgjedhës investitor i impiantit të ri RES-E me çmime të kontratës, të cilat janë të fiksuara ndërmjet prodhuesit RES-E dhe furnizuesit në fillim të secilës kontratë individuale (çmimet e PPA-së) për 15 vjet, pavarësisht nga çmimi i tregut të hapur (çmimi i tregut). Për çdo kwh të blerë në bazë të një PPA-je, furnizuesi do të marrë një të ashtuquajtur pagesë -Tarifë Promovuese/Feed-in - nga një fond, shumë e cila në bazë të rregullave të ndihmës shtetërore duhet të ndryshojë sipas çmimit mesatar vjetor të tregut.

12. Tarifat *feed-in* janë tarifa fikse me të cilat blihet energjia e prodhuar nga HEC-et e vegjël. Kjo lloj tarife ka rezultuar veçanërisht e suksesshme në nxitjen e prodhimit të energjisë elektrike nga energjia hidrike dhe energjia e erës. Ajo është e thjeshtë të aplikohet. Tarifa *feed-in* duhet të jetë e ndryshme për teknologji të ndryshme (erë, ujë, diell, biomase etj.), dhe shpesh është e ndryshme për madhësi të ndryshme të impianteve gjeneruese të së njëjtës teknologji. Këto tarifa duhet të reflektojnë rritjen e çmimeve të energjisë elektrike si rezultat i inflacionit apo edhe ndikimin e mundshëm (por të paneglizhueshëm) të faktorëve të tjerë relevante. Zgjidhja e drejtë e tarifës *feed-in* është mjaft tërheqëse për investitorët privatë, por edhe për bankat që financojnë investimet në BRE (burime të rinovueshme të energjisë). Në vendet e BE-së investitorët/prodhuesit e energjisë elektrike nga BRE-të po orientohen nga vendet ku këto tarifa janë më të larta.

13. Në Bashkimin Evropian, rregullat e ndihmës shtetërore për prodhimin e energjisë së rinovueshme kanë ndihmuar në arritjen e objektivave mjedisore të BE-së. Sipas objektivave aktualë të BE-së, deri në vitin 2020, një e pesta (20 për qind) e të gjithë konsumit të energjisë duhet të vijë nga burime të rinovueshme. Në vitin 2012, BE mesatarisht ka konsumuar 14.1% të energjisë së saj nga burimet e rinovueshme³. Bazuar në zhvillimet dhe politikat aktuale, mesatarja e BE-së e burimeve të rinovueshme në konsumin e energjisë mund të arrijë në 20.9% deri në vitin 2020 (shih figurën 1).

³ European Commission, study commissioned by the European Commission. Graph available in annex 2 of the Communication “Taking stock of the Europe 2020 strategy for smart, sustainable and inclusive growth” COM(2014)130.




Figura 1: Mesatarja e BE e energjisë së rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë, 2000-2020

14. Por skemat e mbështetjes nuk janë më kosto efektive⁴: Për të mbështetur burimet e rinovueshme të energjisë, shtetet anëtare kryesisht përdorin tarifën e vendosura në mënyrë administrative (FiTs) ose *premiumet-feed-in*. Kjo mbrojtje e prodhuesve të energjisë së rinovueshme nga sinjalet e tregut dhe ndryshimeve të çmimeve të energjisë elektrike nuk u jep atyre një nxitje ekonomike për të përshtatur karakteristikat e projektit (si p.sh.: vendndodhja, dizenjimi i instalimit apo operimi aktual) kundrejt elasticitetit të kërkesës dhe ofertës.

Figura 2 më poshtë tregon se shumë shtete anëtare shpenzojnë shuma të mëdha në skemat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë (RES-e), si në terma absolutë, ashtu edhe për MWh.




Figura 2. Mbështetja e BRE-e në Evropë në € milion dhe për njësi të energjisë së konsumuar.⁵

⁴ Improving State Aid for Energy and the Environment

⁵ Burimi: CEER, qershor 2013



15. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton se pagesat e FIP janë themeluar duke u bazuar në metodologjinë për llogaritjen e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga pjesa e biodegradueshme si burim i rinovueshëm për shfrytëzimin e MNU-së. Kjo metodologji përcakton kostot e të gjitha proceseve që shoqërojnë zhvillimin e projekteve të trajtimit të mbeturinave urbane me djegie ose incenerim. Elementet që përbëjnë kostot e prodhimit të energjisë elektrike nga këto projekte të vogla në përgjithësi janë:

a) Lloji i teknologjisë për incenerimin e mbetjeve të ngurta urbane bazuar në eficiencën e energjisë (rendimentit) të gjeneratorit për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti termik, si referencë për sasinë e djegshme që gjenerohet në përmbajtjen e MNU-së.

b) Përmbajtja energjetike (fuqia kalorifike) e MNU-së.

LCOE - kostoja e mesatarizuar e energjisë elektrike, e shprehur në euro/mwh, përfaqëson koston totale përgjatë ciklit të jetës për prodhimin e një mwh energji elektrike, duke përdorur një teknologji të caktuar për të shfrytëzuar pjesën e biodegradueshme si burim i rinovueshëm për mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Ky është faktori përcaktues i njëjtë për mbështetjen e nevojshme për të gjitha burimet e rinovueshme në përgjithësi, me elementet e mëposhtme:

i) Shpenzimet ose kosto kapitale të investimit, CI - kjo kosto përfshin koston totale për zhvillimin dhe ndërtimin e impiantit, përveç kostove për lidhjen me rrjetin e energjisë elektrike.

ii) Kosto e operimit, $C_{o\&km}$ përfshin shpenzimet totale vjetore të operimit që nga viti i parë i operimit të projektit për periudhën e vetëshlyerjes; kjo për njësi të kapacitetit të instaluar.

iii) Faktori i ngarkesës është raporti midis sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar në mwh/vit të dhënë ndaj energjisë elektrike që do të gjenerohej për punë me ngarkesë të plotë dhe të vazhduar gjatë një viti pa ndërprerje ose për 8760 orë të plota.

Të tre këta elementë janë përcaktues në vendosjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga këto lloje të teknologjisë.

VI. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

16. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet në bazë të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga neni 71, “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit”.

17. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, të gjitha këto kushte:

a) aktivizohen burime shtetërore;

b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe

c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;

d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohej çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

Skema e njoftuar financohet nëpërmjet një fondi të mbledhur nga të gjithë abonentët në rrjetin elektrik (burime shtetërore). Skema ndikon në tregtinë e energjisë elektrike, e cila mund të bëhet ndërmjet vendit tonë dhe vendeve të rajonit apo shteteve anëtare të BE-së duke sjellë efekt në konkurrencën midis gjeneruesve të RES-E dhe energjisë elektrike nga burimet tradicionale të energjisë. Për sa i përket selektivitetit dhe avantazhit ekonomik të skemës së njoftuar, Komisioni vlerëson se nga kompensimi i paguar nga furnizuesi (OSHEE sh.a.) përfitojnë në mënyrë



indirekte vetëm prodhuesit e energjisë nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, vetë prodhuesit e RES-E, të cilët në këtë mënyrë janë në gjendje të shesin energjinë elektrike me një çmim të garantuar dhe të kompensuar të furnizuesi, të cilën nuk do ta kishin përfituar dot në kushtet e tregut.

18. Tarifatat nxitëse i mundësojnë prodhuesve të energjisë alternative mbulimin e kostos së prodhimit për një kohë të caktuar, duke i bërë më konkurrues në treg. Politika e tarifave nxitëse përdoren si një formë stimulimi e avancuar e bazuar në prodhim, kjo sepse pagesat bëhen për energjinë elektrike të prodhuar dhe jo për kapacitetin e instaluar. Pagesa më e zakonshme e tarifave nxitëse është e bazuar në koston aktuale të niveluar të energjisë së pastër. Kjo mënyrë e pagesës ofron një çmim të përshtatshëm për të siguruar një normë të arsyeshme të kthimit të investimit për investitorët. Politikat më të suksesshme të tarifave nxitëse janë të bazuara në çmimet e ofruara për furnizuesit në koston e prodhimit të nivelizuar të energjisë alternative, në mënyrë që të sigurojë një normë të arsyeshme të kthimit të investimit. Tarifatat nxitëse synojnë që investitorit t'i sigurojnë një kontratë afatgjatë të garantimit të çmimit me të cilin investimi do të kthehet. Tarifatat nxitëse kanë për qëllim lidhjen e një kontrate afatgjatë me investitorin. Praktikata e shteteve evropiane tregojnë se tarifatat nxitëse zbatohen për një periudhë afatgjatë prej 15-25 vjet. Nxitja e investimeve dhe zhvillimi i prodhimit të energjisë elektrike nga biomasa do të ishte përfitim i dyfishtë. Kjo pasi shfrytëzimi i mbeturinave si masë për prodhimin e energjisë do të ulte nivelin e tyre të përgjithshëm dhe njëkohësisht do të mundësonte prodhim të energjisë nga një burim i rinovueshëm.

Konkluzioni

Sa më lart, paraprakisht shprehemi se kjo masë përfshin elementë të ndihmës shtetërore në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar dhe nenin 107 (1) të TFEU-së. Në njoftim nuk përcaktohet kohëzgjatja e ndihmës, por në formulën e kostos së mesatarizuar të energjisë elektrike (*Levelized cost of Electricity* - LCOE) jetëgjatësia ekonomike e impiantit është supozuar 20-25 vite jeta ekonomike, e cila në fakt korrespondon me atë të aseteve kapitale në këtë skemë. Në njoftim nuk jepet kohëzgjatja e skemës, por nuk mund të kalojë 15

vjet. Gjithashtu, Komisioni konsideron se shkalla e kthimit të investimit e supozuar nga dhënësi i ndihmës korrespondon me një kthim të arsyeshëm të kapitalit. Komisioni vëren se mekanizmi i tarifave fikse- FIP është projektuar në mënyrë të tillë që niveli i mbështetjes të bazohet në ecurinë e çmimit të tregut. Rreziku që zhvillimi i teknologjisë mund të reduktojë kostot e investimeve të projekteve të ardhshme nën nivelin e garantuar të mbështetjes, është i pranishëm duke qenë se kohëzgjatja e masës së njoftuar nuk është e përcaktuar. Në këto kushte, Komisioni konstaton se njoftimi i masës është në përputhje me kushtin e mungesës së mbikompensimit, nëse sigurohet që dhënësi i ndihmës të zbatojë detyrimin për raportimin dhe monitorimin vjetor të ndihmës të parashikuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

VII. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

19. Njoftimi i skemës është në përputhje me udhëzimin e Komisionit Evropian⁶ për Mbrojtjen e Mjedisit, e cila parashikon në kapitullin 3.1.6.2 ndihmën operationale nga burimet e rinovueshme të energjisë. Më konkretisht, skema e njoftuar është në përputhje me pikën 3.3.2.2.,⁷ “Ndihma për energjinë nga burimet e rinovueshme”, e cila ofron mundësinë për të dhënë ndihmë operationale për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga mbeturinat industriale, urbane dhe rurale. Ndihma operationale për energjinë nga burimet e energjisë së rinovueshme të ndryshme nga energjia elektrike jepet nëse është në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) ndihma për njësi e energjisë nuk kalon diferencën ndërmjet koston minimale me të cilën duhet shitur energjia elektrike (LCOE) e prodhuar nga kjo teknologji dhe çmimit të tregut për këtë lloj të energjisë;

b) LCOE mund të përfshijë një kthim normal të kapitalit. Nëse jepet edhe ndihmë për investim, atëherë kjo i zbritet vlerës gjithsej të investimit kur llogaritet LCOE;

c) kostot e prodhimit përditësohen rregullisht, të paktën një herë në vit; dhe

⁶ Communication from the Commission guidelines on state aid for environmental protection and energy 2014-2020 (2014/c 200/01)

⁷ 3.3.2.2. “Aid for energy from renewable sources other than electricity”



d) ndihma jepet vetëm derisa impianti të amortizohet tërësisht sipas rregullave të pranuar të kontabilitetit, në mënyrë që ndihma operationale të mos jetë më e madhe se vlera e amortizimit të investimit.

Sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se skema e njoftuar është në përputhje me udhëzimin e Komisionit Evropian për Mbrojtjen e Mjedisit 2014-2020 dhe vlerëson se skema është në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, neni 13, pika 3, “Ndhimja shtetërore që mund të lejohet”, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhimës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Skema e ndihmës, “Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme”, është në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 13, pika 3, “Ndhimja shtetërore që mund të lejohet”, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Të autorizojë ndihmën shtetërore, “Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme”, mbështetur në nenin 13, pika 2 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me kusht që:

a) ndihma për njësi e energjisë nuk kalon diferencën ndërmjet kostos minimale me të cilën duhet shitur energjia elektrike (LCOE) e prodhuar nga kjo teknologji dhe çmimit të tregut për këtë lloj të energjisë;

b) LCOE mund të përfshijë një kthim normal të kapitalit. Nëse jepet edhe ndihmë për investim, atëherë kjo i zbritet vlerës gjithsej të investimit kur llogaritet LCOE;

c) kostot e prodhimit të përditësohen rregullisht, të paktën një herë në vit; dhe

d) ndihma të jepet derisa impianti të amortizohet tërësisht sipas rregullave të pranuar të kontabilitetit, në mënyrë që ndihma operationale të mos jetë më e madhe se vlera e amortizimit të investimit.

3. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 189, datë 23.11.2017

MBI MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TE KLIENTËT QË FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, germa “b”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neni 6 i VKM-së nr. 244, datë. 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i



ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi miratimin e “Draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 182, datë. 23.11.2016, bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.

- Vendimi u dërgua për publikim në shtypin e shkruar nëpërmjet shkresës nr. 26/44 prot., datë 9.12.2016, të ERE-s, për të marrë opinionin e palëve të interesit.

- ERE ka njoftuar të gjitha palët e interesuara (OSHEE sh.a; MEI; Autoriteti i Konkurrencës; Avokati i Popullit; Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar; Shoqata e Konsumatorit Shqiptar; Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë; Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfindustria).

- U paraqitën komente nga Electricity Trading Origination Manager for Albania and Kosovo.

- ERE organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të ERE-s dhe OSHEE sh.a. gjatë së cilës nuk u konstatuan të meta në draft.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Metodologjia e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)

Neni 1

Baza ligjore

Kjo metodologji hartohet në përputhje me nenet 19/b; 47; 79/4; 81/4; 83; 85 dhe 109 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, nenet 21 dhe 22 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, vendimit të bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të Shërbimit Universal”.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave për vendosjen e çmimeve me pakicë të energjisë elektrike, për klientët fundorë të cilët furnizohen nga FSHU.

Neni 3

Objekti

Kjo metodologji ka si objekt përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për kategoritë e mëposhtme të klientëve që furnizohen nga FSHU në zbatim të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016:

Klientët e lidhur në rrjetin shpërndarjes 20 kV, 10 kV dhe 6 kV;

Klientët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes 0.4 kV deri në momentin që ERE të vendosë që këta



klientë përfitues të shërbimit universal të mund ta blejnë energjinë elektrike në treg me çmime të parregulluara, sikurse kërkohet nga neni 9 i kushteve për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal për tregun e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016.

Neni 4

Përkufizime

Termet e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim si ai i përshkruar në nenin 3 e në vazhdim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Termet e veçantë të përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. Shërbim Universal i Furnizimit është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t’u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.

2. Borxh i keq – një vlerë e lejuar në të ardhurat e kërkuara të FSHU-së nga llogaria klientë, e cila nuk ka më shpresë arkëtimi.

3. Shpenzimet e amortizimit – kostot e amortizimit të lidhura me aktivet afatgjata materiale që përdoren për ofrimin e shërbimit universal, si dhe kostot e amortizimit të lidhura me aktivet afatgjata jomateriale, si programet kompjuterike që përdor FSHU-ja, siç përcaktohet në standardet e kontabilitetit në fuqi.

4. Kostoja për energjinë dhe kapacitetin është kostoja që përballon FSHU-ja për energjinë elektrike dhe kapacitetin që nevojitet për t’u shërbyer klientëve që plotësojnë kushtet për marrjen e shërbimit universal dhe që përfshin: (1) blerjet e energjisë elektrike nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti në përputhje me kushtet e kontratës vjetore ndërmjet palëve, të miratuar nga ERE, në përputhje me nenin 5.2 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016; (2) blerjet e energjisë elektrike në tregun e parregulluar përtej sasisë së kontraktuar me shoqërinë e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti; (3) kostot e lidhura me pagesat

për balancimin, si dhe çdo kosto tjetër që ka të bëjë me blerjen e energjisë elektrike dhe të kapacitetit; (4) kostot përkatëse të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme.

5. Kostoja e përdorimit të sistemit të transmetimit – vlera që do t’i paguhet Operatorit të Sistemit të Transmetimit për përdorimin e sistemit të transmetimit sipas tarifave të miratuara nga ERE.

6. Kostoja e përdorimit të sistemit të shpërndarjes – vlera që i paguhet OSSH-së për përdorimin e sistemit të shpërndarjes, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

7. EURIBOR – norma e ofertës ndërbankare të Federatës Europiane të Bankave për depozitat me afat 3-mujor në euro, siç tregohet në faqen përkatëse të *Reuters* në ose rreth orës 11:00 paradite sipas orës qendrore europiane (CET). Norma e përdorur do të jetë normë vjetore.

8. Kostot e mirëmbajtjes dhe të operimit – kostot që përballon FSHU-ja në lidhje me: (1) kostot direkte të mirëmbajtjes të lidhura me aktivitetin e FSHU-së; (2) kostot të përgjithshme dhe administrative të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e FSHU-së; (3) kostot e lidhura me pagesat e licencimit dhe rregullimit të FSHU-së.

9. Periudhë rregullatore – periudha 12-mujore që përdoret nga rregullatori për të përcaktuar të ardhurat e kërkuara nga i licencuari, me qëllim të përcaktimit të çmimeve.

10. Të ardhurat e kërkuara – shuma e të ardhurave që i nevojitet një të licencuari të mirëmenaxhuar për të kryer aktivitetin për të cilin është licencuar për periudhën rregullatore. Kjo sasi të ardhurash propozohet nga i licencuari dhe miratohet nga rregullatori.

11. Marzhi i fitimit – një përqindje fikse që aplikohet mbi kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe kapacitetit nga ana e FSHU-së.

12. Kapitali i punës (WC) – fondi i nevojshëm për të përballuar diferencën në kohë midis kryerjes së shpenzimit për sigurimin e shërbimit dhe vjeljes së të ardhurave nga klientët gjatë aktivitetit.

13. Shuma e lejuar për “Kapitalin e punës” (WCA) – vlera e lejuar që i jepet FSHU-së në të ardhurat e kërkuara për mbulimin e kostos së fondeve të huajtura që përdoren në aktivitetin e përditshëm.



Neni 5

Procesi i rishikimit të çmimeve

1. Çmimet e shitjes me pakicë të FSHU-së rishikohen dhe miratohen mbi baza vjetore, siç përcaktohet në nenin 85 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Periudha rregullatore gjatë së cilës do të jenë në fuqi këto çmime, do të jetë një parashikim për 12 muajt e ardhshëm.

3. Procesi i përcaktimit të çmimeve kërkon që FSHU-ja të paraqesë në ERE aplikimin për çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike te klientët fundorë të shërbyer prej tij, me përmbajtje si më poshtë:

- Një listë të të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale të FSHU-së për 12 muajt e fundit, të përgatitura sipas standardeve të kontabilitetit në fuqi.

- Të dhëna për energjinë elektrike të blerë nga FSHU-ja (sipas burimit) dhe energjisë elektrike të shitur për çdo kategori klientësh për 12 muajt e fundit.

- Parashikimin e energjisë elektrike që FSHU-ja do të prokurojë për 12 muajt e ardhshëm për të përmbushur kërkesat e çdo kategorie klientësh që plotësojnë kushtet për t'u furnizuar nga FSHU-ja.

- Parashikimin e të ardhurave të kërkuara të FSHU-ja për periudhën rregullatore, objekt i shqyrtimit.

- Shpërndarja e të ardhurave të kërkuara për periudhën e parashikuar sipas kategorieve të klientëve që furnizohen nga FSHU-ja.

- Shpërndarja e kërkuar për strukturën e propozuar të çmimeve për të përfutur të ardhurat e kërkuara për çdo kategori çmimesh.

ERE shqyrton të dhënat dhe informacionin e paraqitur nga i licencuari, informacioni i cili paraqitet në ERE në përputhje me nenin 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, dhe shprehet nëse informacioni është apo jo i plotë. Në rast se të dhënat nuk janë të plota, ERE njofton të licencuarin për mangësitë, duke i lënë atij një afat për të paraqitur informacionin shtesë apo të korigjuar. Informacioni i paraqitur nga i licencuari vihet në dispozicion të publikut. ERE analizon informacionin e paraqitur nga i licencuari dhe jep

opinion në lidhje me arsyeshmërinë, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e informacionit të paraqitur. Në rastet kur ERE nuk e gjen informacionin e dhënë të saktë ose të plotë, do të shpjegojë arsyet për mosdakordësinë e saj dhe propozon vlera alternative të arsyeshme dhe të justifikuara.

4. Nëse FSHU-ja nuk bie dakord me vendimin e ERE-s për tarifat, ai mund ta apelojë vendimin në Gjykatë sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët sipas nivelit të tensionit ku janë lidhur, do të reflektojnë plotësisht kostot që ato shkaktojnë për marrjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

Neni 6

Përcaktimi i të ardhurave të kërkuara

1. Të ardhurat e kërkuara (RR) të Furnizuesit Universal do të përbëhen nga elementet e mëposhtme:

a. Kostoja për energjinë elektrike dhe kapacitetin

Kjo kategori përfshin kostot e energjisë elektrike dhe kapacitetit të nevojshëm për t'u shërbyer klientëve që plotësojnë kriteret për marrjen e shërbimit universal. Si i tillë ai përfshin:

- Energjinë elektrike të blerë nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht apo pjesërisht nga shteti në përputhje me kushtet e kontratës vjetore ndërmjet palëve, miratuar nga ERE dhe me nenin 5.2 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016.

- Energjinë elektrike dhe kapacitetin e kërkuar përtej sasisë së vënë në dispozicion nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht apo pjesërisht nga shteti, në përputhje me rregullat e tregut.

- Kostot e lidhura me disbalancat përkatëse, si dhe çdo lloj kostoje tjetër që ka të bëjë me sigurimin e energjisë elektrike dhe kapacitetit që kërkohet.

- Pagesa e tarifës për operatorin e tregut në përputhje me rregullat e tregut dhe/apo ato të Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE).

b. Kostot e transmetimit

Kjo kategori përfshin shumat që do t'i paguhen Operatorit të Sistemit të Transmetimit për përdorimin e rrjetit të transmetimit sipas tarifës së miratuar nga ERE.



c. Kostot e shpërndarjes

Kjo kategori përfshin shumat që do t'i paguhen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për përdorimin e sistemit të shpërndarjes, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

d. Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes

Kjo kategori përfshin kostot direkte të operimit dhe mirëmbajtjes të FSHU-së, si dhe kostot të përgjithshme dhe administrative të lidhura drejtpërdrejt me funksionimin e FSHU-së sipas standardeve të kontabilitetit në fuqi. Çdo kosto licencimi dhe rregullimi e FSHU-së do të përfshihet në këtë kategori.

Kostot e lidhura me ndërgjegjësimin publik që kanë të bëjnë me sigurimin teknik, inkurajimin e klientëve për pagimin e faturave të energjisë elektrike në kohë, si dhe dekurajimin e klientëve për përdorimin e metodave abuzive në konsumin e energjisë elektrike do të përfshihen në kostot e lejuara të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Kostot e publicitetit apo çdo formë tjetër marketingu me qëllim inkurajimin e rritjes së konsumit nuk do të lejohen të përfshihen në kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.

e. Shpenzimet e amortizimit

Janë kostot e amortizimit të lidhura me aktivet afatgjata materiale që shërbejnë për sigurimin e shërbimit universal, siç përcaktohet në standardet e kontabilitetit. Në këtë kategori do të përfshihet gjithashtu çdo kosto amortizimi që ka të bëjë me aktivet afatgjata jomateriale, të tilla si programet kompjuterike, që përdoren nga FSHU-ja.

f. Marzhi i fitimit

Marzhi i fitimit do të jetë një përqindje fikse që aplikohet mbi kostot për blerjen e energjisë elektrike dhe kapacitetit. Niveli i marzhit të fitimit do të përcaktohet i tillë që t'i mundësojë FSHU-së një fitim të arsyeshëm që kompenson riskun që i licencuari merr për ofrimin e këtij shërbimi ndaj klientëve që e përfitojnë atë. Ky marzh do të përcaktohet duke pasur parasysh marzhet e përfituara nga shoqëri të ngjashme në rajon, duke marrë në konsideratë ngjashmërinë ndërmjet industrisë së energjisë elektrike të atyre vendeve me Shqipërinë, por jo më shumë se 3%.

ERE mund të vendosë më tej për ndonjë axhustim të nevojshëm, aty ku ndryshimet janë sinjifikative. Marzhi i fitimit (RM) llogaritet si më poshtë:

$RM = E \times (\%)$ e lejuar,

ku E është kostoja për blerjen e energjisë dhe kapacitetit

g. Vlera e lejuar për “kapitalin e punës” (WCA)

Baza për përcaktimin e vlerës së lejuar të kapitalit të punës do të jetë 1/12 e shumave të elementeve të lejuara si më poshtë:

- Kosto e energjisë elektrike dhe kapacitetit (E)

- Kosto shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes (TF + DUOS)

- Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes (OM)

Formula e llogaritjes së kapitalit të punës është si më poshtë:

$$WC = \frac{1}{12} * (E + TF + DUOS + OM)$$

Kostoja e financimit të kapitali të punës do të bazohet në kostot e borxhit afatshkurtër të të licencuarit. Në rast se një vlerë e tillë nuk mund të përcaktohet, do të aplikohet një normë e njëjtë me EURIBOR, si dhe një përqindje shtesë prej x%. Kjo përqindje shtesë (x) do të bazohet në situatën e tregjeve rajonale financiare në momentin e përcaktimit. Me qëllim të rishikimit të tarifave për herë të parë, kjo shtesë do të jetë në nivelin 3% të vlerës.

Vlera e lejuar për “kapitalin e punës” llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$WCA = WC \times WCC$$

ku:

WCA- vlera e lejuar e kapitalit të punës

WC - kapitali i punës

WCC- kostoja e financimit të kapitalit të punës

h. Borzhi i keq

Borzhi i keq do të jetë vlera e lejuar në të ardhurat e kërkuara (RR). I licencuari (Shoqëria) do të propozojnë një vlerë për borxhin e keq, të cilën ERE do të duhet ta vlerësojë nëse është e arsyeshme.

Për menaxhimin me efektivitet të llogarive të arkëtueshme nga ana e FSHU-së, ERE mund të vendosë një objektiv rregullator për borxhin e keq për t'i dhënë Shoqërisë nxitje për uljen e këtij niveli, krahasuar me atë të vitit paraardhës.

i. Korrigjimi i të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës (AXH)



Në rast se i licencuari, gjatë vitit parardhës ka realizuar më shumë apo më pak të ardhura të kërkuara se ato të lejuara, ato do të korrigojnë për rastet e mëposhtme:

- Diferencat në sasinë e energjisë elektrike të parashikuar dhe asaj të faturuar;
- Diferencat për kostot e parashikuara dhe ato të realizuara të energjisë elektrike dhe kapacitetit në çmimin për njësi (kwh);
- Diferencat ndërmjet kostove të parashikuara për njësi dhe atyre të realizuara të transmetimit dhe shpërndarjes;
- Diferencat që vijnë nga një strukturë shitjeje e realizuar e ndryshme nga ajo e miratuar;
- Pagesës së bërë nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti në përputhje me nenin 5.3 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016.

2. Kërkesa për të ardhura (RR) e FSHU llogaritet sipas formulës më poshtë:

$$RR = E + TF + DUOS + OM + DA + RM + WCA + BD + AXH$$

ku:

E	kostoja për blerjen e energjisë elektrike dhe kapacitetit
TF	kostoja për përdorimin e sistemit të transmetimit
DUOS	kostoja për përdorimin e sistemit të shpërndarjes
OM	kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes
DA	kostoja e amortizimit të asetëve
RM	marzhi i fitimit
WCA	vlera e kostos së financimit të kapitalit të punës
BD	borxhi i keq
AXH	korrigjimi i të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës

Neni 7

Ndarja e të ardhurave të kërkuara sipas strukturës së çmimeve

1. Të ardhurat e kërkuara të përcaktuara sipas nenit 4 duhet të ndahen sipas strukturës së çmimeve, duke përdorur parimet bazë si më poshtë:

a. Kostot e energjisë elektrike dhe të kapacitetit do të ndahen sipas kategorive të klientëve, bazuar në grafikun e ngarkesës, duke

reflektuar kohën e përdorimit, përfshirë modelet sezonale të konsumit në periudhën e pikut dhe atë jashtë saj për secilën kategori klientësh.

b. Pagesat e përdorimit të sistemit të shpërndarjes do të ndahen për çdo kategori klientësh, bazuar në nivelin e tensionit në të cilin ofrohet shërbimi.

c. Pagesat e përdorimit të sistemit të transmetimit do të caktohen sipas kategorive të klientëve, bazuar në përqindjen e kwh, që përdoren nga secila kategori klientësh.

d. Vlera e kapitalit të punës do t'u shpërndahet kategorive të klientëve, bazuar në pjesën që i takon çdo kategorie klientësh të përmendur në paragrafët a, b dhe c.

e. Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet e amortizimit, si dhe marzhi i fitimit do të shpërndahen sipas kategorive të klientëve, bazuar në përqindjet e energjisë së shitur për çdo kategori.

f. Shpenzimi për borxhin e keq do të llogaritet për çdo kategori klientësh, bazuar në përqindjen e borxhit të keq të 12 muajve të fundit, të korrigjuar me një koeficient inkurajimi të vendosur nga ERE.

g. Korrigjimi i të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës do të shpërndahet sipas kategorive të klientëve, bazuar në përqindjet e shitjeve në kwh.

Neni 8

Përcaktimi i çmimeve për secilën kategori klientësh

1. Të ardhurat e kërkuara për çdo kategori klientësh, të përcaktuara sipas nenit 5, do të krahasohen me të ardhurat e pritshme bazuar në nivelin aktual të çmimeve për çdo kategori klientësh. Tepricat apo mungesat do të identifikohen për secilën nga kategoritë.

2. I licencuari do të shqyrtojë elementët aktualë të faturimit për secilën kategori të çmimeve dhe do të propozojë ndryshime të këtyre elementëve që mund të përfshijnë (në varësi të kategorisë së konsumatorëve apo aftësisë matëse):

- Tarifën mujore fikse;
- Tarifën e energjisë (lekë/kwh);
- Tarifën për kapacitetin (lekë/kwh);
- Çmimin për energjinë reaktive (lekë/kVarh);



- Të tjera.

3. I licencuari do të propozojë çmime të reja për çdo kategori klientësh, me qëllim që të mbledhë të ardhurat e kërkuara për secilën nga kategoritë e klientëve.

ERE do të shqyrtojë propozimin e të licencuarit dhe do të bëjë ndryshimet që i gjykon të nevojshme, me qëllim që, deri në 31.12.2017, të miratojë tarifa që reflektojnë plotësisht kostot për çdo kategori klientësh, në mënyrë që t'i mundësojë ata të dalin në tregun e liberalizuar, ashtu siç përcaktohet në nenin 109 të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në nenin 9 të kushteve për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri, të miratuar me vendimin nr. 112, datë 8.7.2016, të bordit të ERE-s.

Neni 9 Miratimi

Kjo metodologji u miratua me vendimin e bordit të ERE-s nr.189, datë 23.11.2017.

VENDIM Nr. 190, datë 23.11.2017

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 17, pikat 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Referuar nenit 17, pika 4, ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në përputhje me rregulloren përkatëse.

- Me vendimin nr. 136, datë 6.9.2017, të bordit të ERE-s, është miratuar fillimi i procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të rregullores, përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

- Në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s draftrregullorja u publikua në median e shkruar dhe nëpërmjet komunikimit zyrtar u kërkuar shprehja e opinionëve dhe komenteve nga ana shoqërive energjetike KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., shoqatave që vepronë në sektorin e energjisë, FIAA, AAES, AREA, ACERC, Shoqatës së Prodhuesve të Vegjël të Energjisë, si edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 386/1 prot., datë 13.10.2017, adresuar ERE-s është shprehur se kjo rregullore nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 22226/1 prot. datë 10.10.2017, protokolluar në ERE, në datë 6.11.2017, jashtë afatit që parashikon rregullorja e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, OSHEE-ja ka shprehur komentet e saj mbi këtë rregullore.

- Në datën 12.11.2017 u organizua në ERE seanca dëgjimore teknike me përfaqësues të shoqërisë OSHEE sh.a., ku u diskutua mbi problemet e ngritura dhe u dhanë sqarimet përkatëse.

- OSHEE sh.a. bëri me dije se metodologjia është e saktë dhe në interpretim të drejtë të legjislacionit në fuqi.

- OSHEE sh.a. propozoi llogaritjen e pagesës përkatëse rregullatore mbi shumën e arkëtuar të të ardhurave në vitin e mbyllur financiar, duke bërë me dije se të ardhurat e arkëtuara janë më të vogla se ato të faturuara.

- ERE i la detyrë shoqërisë OSHEE sh.a. që të propozojë zyrtarisht formulën e arsyetuar e në zbatim të ligjit.

- Nuk rezultoi të jetë depozituar në ERE një propozim për sa më sipër në përfundim të afatit të përcaktuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”(bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Administrim-Financës dhe e Burimeve Njerëzore të njoftojë të licencuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE**MBI PËRCAKTIMIN E MIRATIMIN E PAGESAVE RREGULLATORE**

Neni 1

Autoriteti

Rregullorja për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë elektrike nga Enti Rregullator i Energjisë është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për llogaritjen e pagesave rregullatore/të rregullimit për të gjithë të licencuarit në tregun e energjisë elektrike si një nga burimet kryesore të financimit të ERE-s, me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të rregullimit.

Neni 3

Objektivi

Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes së pagesave rregullatore është të përcaktojë pagesa rregullimi të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike.

Neni 4

Termet e përdorur në metodologji

Termet e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

4.1 Pagesa rregullatore – pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-S-s për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore.

4.2 Të licencuar – shoqëri që janë licencuar nga ERE për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, transmetimit të energjisë elektrike, shpërndarjes/furnizimit të energjisë elektrike, si dhe tregtimit të energjisë elektrike, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, operimit të tregut të energjisë elektrike.

4.3 Të ardhurat nënkuptojnë të ardhurat vjetore të deklaruara në pasqyrat financiare të audituara, referuar standardeve të kontabilitetit në fuqi.

Neni 5

Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

5.1 Kjo rregullore është konceptuar konform nenit 17 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ku parashikohet se:

a. Burimet financiare të ERE-së përbëhen nga pagesat rregullatore, të vendosura nga ajo vetë për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe nga pagesat e licencave.

b. ERE-ja mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.

5.2 Pagesa rregullatore, në zbatim të pikës 52, të nenit 3 të ligjit 43/2015 llogaritet dhe mblidhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licencuar, pavarësisht faktit nëse në momentin e llogaritjes së kësaj pagese kompania nuk e ka filluar aktivitetin për të cilin është licencuar.

5.3 Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.

5.4 Të licencuarit në zbatim të neneve 45 e 46 të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të kushteve të licencës depozitojnë në ERE deri më datë 31 janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej, deri në datë 30 qershor, kopje të audituara të pasqyrave



financiare të periudhës së mëparshme, nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullimit.

5.5 Pagesat rregullatore duhet të miratohen deri në 31 janar të vitit aktual.

Neni 6

Përcaktimi i pagesës rregullatore për të licencuarit në sektorin e energjisë

6.1 Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i çdo të licencuarit ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.

6.2 Pagesa rregullatore për secilin të licencuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t'u shpërndarë, buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga licencimi), të përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

6.3 Për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike që në vitin paraardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 40 mijë lekësh.

6.4 Në rastet kur një shoqëri e licencuar nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, siç parashikon neni 46 i ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", atëherë ERE do të përlllogaritë këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga publikime zyrtare.

Neni 7

Korrigjimi

ERE, me paraqitjen e një kërkesë nga të licencuarit në rast të pasaktësive të llogaritjes në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i licencuar, rillogarit dhe korrigjon pagesën rregullatore të vitit aktual në pagesën rregullatore të vitit pasardhës.

Neni 8

Njoftimi

8.1 ERE, pasi përcakton pagesat rregullatore, njofton të licencuarin për vlerën, afatet e pagesës për vitin ushtrimor, vendin e kryerjes së këtyre pagesave dhe penalitetet në rast se kjo pagesë nuk kryhet në kohë.

8.2 Pagesat rregullatore depozitohen nga ERE në një llogari të veçantë, të hapur në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9

Penalitetet

9.1 Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

9.2 Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1 (b) të nenit 107, të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

9.3 Në rast se i licencuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1 e 9.2 të këtij neni, atëherë ndaj tij bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licencës, siç përcaktohet në pikën 1 (c) të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 10

Dispozita përfundimtare

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë u miratua nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 190, datë 23.11.2017.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin datë 30.10.2017, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Arent Gega, i datëlindjes 8.5.1986, në datë 10 maj 2010.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë